**VENDIM**
**Nr2, date 16.10.2020**

**I ASAMBLESE TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**"TREN SUN SYSTEM" shpk**

Sot, diten e Premte, ne daten 16/10/2020, ne oren 11:00 , u mbajt Asambleja e Ortakeve te shoqerise "TREN SUN SYSTEM" shpk me numer NUIS M06812602A ku moren pjese ortaket:

- **Z. Jorge Jeha,** shtetas brazilian, lindur ne Belo Horizonte, me date 15.06.1953 mbajtes i pashaportes Braziliane me numer. YC067092 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar zoterues i nje kuote me 55% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.
- **Z.Ilir Shtufi,** atesia Xhemal, shtetas shqiptare, lindur me 13.10.1973 ne Tirane dhe banues ne Tirane , mbajtes i ID me Nr. Personal H31013090C, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar zoterues i nje kuote me 45% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise.

me qellim shqyrtimin e rendit te dites si me poshte:

**1.** Aprovimin dhe pranimin e ushtrimit te se drejtes se parablerjes e drejte kjo per tu ushtruar nga ortaku qe ka shprehur interes.
**2.** Aprovimi dhe lejimin per kryerjen e transaksionit te shitjes se nje kuote qe perfaqeson 55 % pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise qe z. Jorge Jeha, ne cilesin e ortakut zoteron tek shoqeria "TREN SUN SYSTEM" shpk , kuote e cila do ti shitet Bleresit Z.Ilir Shtufi.
**3.** Të ndryshme.

ME UNANIMITET VOTASH
VENDOSI

1. Aprovimin dhe pranimin e ushtrimit te se drejtes se parablerjes e drejte kjo e ushtruar nga ortaku Z. Ilir Shtufi, i cili ka shprehur interesin per te blere kuoten e ortakut Jorge Jeha.
2. Aprovimi dhe lejimin per kryerjen e transaksionit te shitjes se nje kuote qe perfaqeson 55 % pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise qe z. Jorge Jeha, ne cilesin e ortakut zoteron tek shoqeria "TREN SUN SYSTEM" shpk , kuote e cila do ti shitet Bleresit Z.Ilir Shtufi. Transaksioni I shitjes do te realizohet nepermjet kontrates ligjore per shitjen e kuotes duke zbatuar dispozitat ligjore ne fuqi.
3. Ne perfundim te transaksionit te lartpermendur te shitjes,kontrata e lartpermendur sebashku me kete vendim do te rregjistrohet prane QKB-se me qellim reflektimin e ndryshimeve ne kuotat dhe pjesmarrjen ne shoqeri e cila do te jete si vijon: ortaku Ilir Shtufi do te zoteroje 1 kuote me 100% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise pra Ortak I vetem I shoqerise "TREN SUN SYSTEM" shpk

* * *                * * *                * * *

Ky vendim pasi lexohet dhe shihet i formuluar sakte dhe shpreh vullnetin e paleve nenshkruhet ne 2 kopje identike ne prani te perkthyeses , me nga nje faqe secila si me poshte.
Prezent ne takim dhe administratori I cili ne perfundim te mbledhjes autorizoi Z. Enea Mitrushi te ndjeke rregjistrimin e ketij vendimi sebashku Kontraten e shitjes se kuotes dhe te gjithe aktet e domosdoshme per realizimin e transaksionit prane QKB-se.

**ORTAKET e shoqerise "TREN SUN SYSTEM"shpk**

**Z. JORGE JEHA**

Administratori
Z. Ilir SHTUFI

TREN SUN SYSTEM Sh.p.k
TSS

**Z.ILIR SHTUFI**

**KONTRATE SHITJE KUOTASH**

Sot me date 19.10.2020 (dymije e njezet) ne zyrat e shoqerise "**Tren Sun System**" shpk me adrese Korce, Bilisht,Rruga Fshati Tren Km 1 ,Parku Photovoltaik, u hartua dhe nenshkrua kjo kontrate nga palet e meposhtme :

**Z. Jorge Jeha,** shtetas brazilian, lindur ne Belo Horizonte, me date 15.06.1953 mbajtes i pashaportes Braziliane me numer. YC067092, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne kete kontrate referuar si **"Shitesi").**
**Jep pelqimin bashkeshortja Z. Ilda Jeha,** shtetase shqipetare, lindur ne Barikat,Berat, me date 29.10.1977 mbajtese e pashaportes shqipetare me nr.BF4018162 dhe nr.Personal H760290621 madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

dhe

**Z.Ilir Shtufi,** atesia Xhemal, shtetas shqiptare, lindur me 13.10.1973 ne Tirane dhe banues ne Tirane , mbajtes i ID me Nr.033617734 dhe Nr. Personal H31013090C, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne kete kontrate referuar si **"Bleresi");**

**MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE:**

A. Shitesi eshte njeri nga ortaket e shoqerise **"Tren Sun System" Shpk,** nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar regjistruar me date 12.06.2020 prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me numer identifikimi NUIS M06812602A (ketu e me poshte e quajtur **"TSS" Shpk**) kapitali i te ciles eshte **100,000** leke.
B. Shitesi zoteron perkatesisht 1 kuote me 55% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise e konvertuar ne vlere kapitali ne 55,000 leke, dhe ortaku tjeter Ilir Shtufi zoteron 1 kuote me 45% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise e konvertuar ne vlere kapitali ne 45,000 leke.
C. Shitesi deshiron ti shes Bleresit 1 kuote prej 55% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "TSS" shpk, shoqeri e cila eshte zoterohet nga Z. Jorge Jeha dhe Z. Ilir Shtufi.
D. Bleresi eshte dakort dhe ka shprehur interes te bej te tijen kuoten prej **55%** pjesmarrje qe gezon shitesi ne shoqerine **"TSS" shpk** dhe Bleresi njeherazi disponon mjetet financiare per te realizuar kete blerje .

**PER SA ME SIPER**, si dhe duke marre parasysh marreveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palet bien dakord si me poshte vijon:

**NENI 1**
**BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE**

Sipas dispozitave te kesaj Kontrate, Shitesi nepermjet ketij akti i shet Bleresit dhe ky i fundit blen 1 kuote e cila perfaqeson 55% te kapitalit te shoqerise "TSS" Shpk.
Kjo kuote blihet me cmimin e percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate

**NENI 2**
**ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES**

**2.1.** Çmimi i blerjes se kuotes objekt i kesaj Kontrate eshte ne vleren prej 55,000 Leke (pesedhejete e pesemije) , me poshte i quajtur "Çmimi i Blerjes", vlere e cila do te likujdohet nepermjet llogarise bankare nga Bleresi ne favor te Shitesit .

**2.2.** Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:
Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Bleresi, pra **Z. Ilir Shtufi**, menjehere rifiton pronesine mbi Kuoten me vlere prej 55,000 Leke (pese mije)te shoqerise "TSS" Shpk, kuote e cila iu shit nga Shitesi sipas kushteve te kesaj kontrate.

**NENI 3**
**DEKLARATAT DHE GARANCITE**

**3.1.** Shitesi deklaron dhe garanton se:
**(i)** nenshkrimi dhe zbatimi e kesaj kontrate eshte autorizuar rregullisht.
**(ii)** Shitesi ka nenshkruar dhe shlyer ne menyre te plote kuoten, objekt i kesaj Kontrate.
**(iii)** kjo kuote qe transferohet eshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjeter ligjor nga pale te treta.
**(iv)** kjo Kontrate nenshkruhet rregullisht sot me date 19/10/2020 dhe eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesin.
**(v)** eshte mbajtur mbledhja pergjithshme e asamblese se ortakeve te shoqeris **"TSS"shpk** ku ortaket kane qene dakort dhe kane pranuar qe Z. Jorge Jeha tia shes kuoten qe zoteron ortakut tjeter, **Z. Ilir Shtufi** .

**3.2.** Bleresi deklaron dhe garanton se:
**(i)** nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht .
**(ii)** ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjeter, per te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj.
**(iii)** kjo Kontrate neshkruhet rregullisht sot ne date 19/10/2020,eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Bleresin.

**NENI 4**

**TE NDRYSHME**

Kjo Kontrate, nenshkruhet ne 2 kopje ne gjuhen shqipe ne prani te perkthyesit dhe perben marreveshjen e plote midis paleve.Kjo kontrate eshte nenshkruar nga vete palet pa noter por ka fuqine e nje akti noterial, sipas ligjeve shqipetare ne fuqi.Bashkelidhur kesaj kontrate eshte dhe vendimi i ortakeve themelues te kesaj shoqerie, vendim ky qe aprovon dhe lejon shitjen dhe blerjen e kuotes nga palet nenshkruese te ketij akti, ortake te shoqerise "TSS"shpk.

**NENI 5**

**LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET**

**5.1.** Problemet ne lidhje me çeshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.

**5.2.** Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate u hartua ne 2 (dy) kopje identike me nga 3(tre) faqe secila ,ne gjuhen shqipe dhe pasi iu lexua qarte paleve prej meje, ne prani te perkthyeses se gjuhes angleze pasi Shitesi eshte shtetas i huaj, te cilet deklaruan se e kane kuptuar qartë permbajtjen e saj, pranojne se pasqyron vullnetin e tyre te lire e të plotë dhe pas kesaj e nenshkruan me vullnet te lire.

**PALET**

**SHITESI**
**Z. Jorge JEHA**

**Jep pelqimin Bashkeshortja**
**Znj. Ilda JEHA**

**BLERESI**

**Z.Ilir SHTUFI**

Raiffeisen BANK

Data : **19-10-2020**

Dega: **001-Dega Rruga e Kavajës**

Arka/Nr Veprimit : **ATA-0050**

Ref : **20201019Albana.Aluku00149703**

## Depozitim Per te Trete

Urdheruesi : **BESJANA ZEF LULI**

Perfituesi : **JORGE EDMUND JEHA** Nr Llogarise : **0000728726**

Komision **ALL 125.00**

Totali Ne Llogari : **ALL 55,000.00**

Shuma e Klientit : **ALL 55,125.00** Kursi : **1.00**

Pershkrimi i Veprimit: ILIR SHTUFI PAGPER BLERJE KUOTASH TREN SUN SYSTEM SHPK DERDH BESJANA LULI

| Sasia | Prerjet | Vlera | |
|---|---|---|---|
| 11 | 5,000.00 | 55000.00 | |
| 1 | 200.00 | 200.00 | |
| 1 | 50.00 | -50.00 | Kusur |
| 1 | 20.00 | -20.00 | Kusur |
| 1 | 5.00 | -5.00 | Kusur |
| | Totali : | **55,125.00** | |

Arketari

Albana.Aluku

Klienti

**Rifreskoni kontaktet tuaja!**

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj te saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products and services, and other.